



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr.536/10

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Ferit Osmani kryesues, Vllastimir Dimiq dhe Nehat Idrizi, anëtarë, duke vendosur përkitazi për ankesën e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), paraqitur kundër komisionerit në Lulzim Kajtazi për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor, në seancën e panelit të mbajtur me 15.12.2010, mori këtë:

VENDIM

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV).

ARSYETIMI

Më datën 13.12.2010 PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjekti politik LVV në të cilën theksohet se me datën 12.12.2010 në shkollën fillore Hivzi Sylejmani në fshatin Kqiq i Madh në QV 1112b/04D, Lulzim Kajtazi mbikëqyrës i rreshtit në QV në fjalë edhe pse e ka ditur se nuk guxon të lejohen që përnjëher të futen grumbull personash, ai megjithatë ka lejuar që në klasë të futen 12 persona përnjëher edhe pse në atë moment ishin duke votuar edhe 4 persona të tjerë. Me atë rast vëzhguesi i subjektit politik LVV ka kundërshtuar që këta persona mos të futen në këtë mënyrë pa u kryer procedura e identifikimit, mirpo ai prap se prap ka lejuar një gjë të tillë.

Ndërsa në po të njejtën klasë dhe në po të njejtin QV1112b/04D anëtarët e subjektit politik PDK Rustem Abiti dhe Banush Pllana, kanë hyrë herë pas here në këtë klasë dhe kanë pyetur se sa vota janë, ku me atë rastë komisioneri Rustem Ibishi është përgjigjur se janë 49 vota duke thënë se 30 janë të PDK-ës

Ne mbështetje të pretendimeve parashtruesi i ankesës nuk i ka bashkangjitur ankesës asnjë prove materiale.

Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, specifikon:

118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet.

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 3.6, pika (c) parashohin si vijon:

3.6 (c) Hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, ne rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit

PZAP pasi shqyrtoj dhe analizoi të gjitha shkresat e lendes gjeti se:

-ankesa është e pabazuar

PZAP-i konstaton se ankesa është e pabazuar për faktin se nuk i përmban elementet e detyrueshme të parashikuara në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së dhe elementet e parashikuara në nenin 3.6 pika c) të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, për shkakun se parashtruesi i ankesës nuk i ka bashkangjitur ankesës asnjë provë materiale, që do të shërbente si dëshmi rreth rastit në fjalë. Për këto arsye dhe bazuar në dispozitën e nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 536/2010 më datën 15.12.2010

